

KËRKESË
Nr. 646, datë 2.2.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit, “Pedonalja e qytetit”, Ura Vajgurore.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Ura Vajgurore.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 1,574,002 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dy) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

TABELA E PASURIVE QE SHPRONESOHEN QE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "Rehabilitim, ndricim i shëtitorës së lagjes "18 Tetori " Ura Vajgurore", Pedonalja e qytetit".

Nr	Pronari		Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Lloji i ndertimit	Siperfaqia		Çmimi		Vlera		Shenime
						Truall	Ndertim	Truall	Ndertim	Truall	Ndertim	
	Emri	Mbiemri				m2	m2	lek	lek	lek	lek	
1	ZENEPE	KASA	3682	2/733	SHERBIM	30	30	2646	situacion	79380	1494622	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
	Shuma					30	30			79,380	1,494,622	
								VLERA TOTALE			1,574,002	Leke

Shënim: Çmimi I truallit për qytetin e Ures Vajgurore eshte 2646 lekë/m² sipas VKM

